



## RAPORT

### PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT

#### “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

##### 1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”.

##### 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Qëllimi i projektligjit "Për sektorin e energjisë elektrike" është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurtë me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe nevoja për të integruar tregun shqiptar të energjisë elektrike me tregjet e tjera rajonale të energjisë elektrike dhe tregun e integruar evropian të energjisë elektrike. Duke vepruar kështu, ligji do të promovojë çmime dhe kosto të përballueshme e transparente të energjisë për konsumatorët, do të rrisë të drejtat dhe mbrojtjen e tyre, do të promovojë efikasitetin energjetik dhe do të sigurojë një tranzicion të qetë drejt një sistemi energjetik të qëndrueshëm me karbon të ulët.

Ky projektligj synon ndër të tjera përfshirjen e dispozitave nga Paketa e Energjisë së Pastër të Bashkimit Europian ("EU CEP") në lidhje me tregun e energjisë elektrike. Objektivi i dispozitave të propozuara është përafrimi i projektligjit të energjisë elektrike me katër aktet ligjore të BE-së që janë pjesë e CEP-së së BE-

së, që janë Direktiva e Energjisë Elektrike (BE) 2019/944 (reformular), Rregullorja e Energjisë Elektrike (BE) 2019/943, Rregullorja e Gatishmëria ndaj rrezikut (BE) 2019/941 (reformular), Rregullorja ACER (BE) 2019/942 (në çdo rast siç është miratuar nga Këshilli Ministrave të Komunitetit të Energjisë), të cilat synojnë arritjen e dimensioneve kyçe të Unionit të Energjisë, si: (a) kontribuimi në sigurinë e energjisë, solidaritetin dhe besimin, (b) krijimi i një tregu plotësisht të integruar të energjisë, (c) de karbonizimi i ekonomisë, duke kontribuar gjithashtu tërthorazi në dy dimensionet e tjera (efikasiteti i energjisë që kontribuon në moderimin e kërkesës dhe në Kërkimin, Inovacionin dhe Konkurrueshmërinë).

Ky projektligj është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel ekspertit dhe qytetari) në datë 1 Korrik 2025 deri në 29 Korrik 2025, për një periudhë 20 ditë pune, në respektim të afatit ligjor të konsultimit.

Gjithashtu është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel ekspertit dhe qytetari) edhe në datën 22 Prill 2026 deri në 20 Maj 2026, për një periudhë 20 ditë pune, në respektim të afatit ligjor të konsultimit.

### **3. Metoda e konsultimit**

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, u konsultua:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 1 Korrik 2025 deri në 29 Korrik 2025;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 1 Korrik 2025 deri në 29 Korrik 2025 të projektligjit dhe paketës shoqëruese;
3. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 22 Prill 2026 deri në 20 Maj 2026;

4. Njëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 1 Korrik 2025 deri në 29 Korrik 2025 të projektligjit dhe paketës shoqëruese;
5. Njëpërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: [vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al](mailto:vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al).
6. Njëpërmjet organizimit të tryezës së parë të diskutimit dhe konsultimit, zhvilluar më datë 19 mars 2026, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në sektorin e energjisë elektrike;
7. Njëpërmjet organizimit të tryezës së dytë të diskutimit dhe konsultimit, zhvilluar më datë 8 prill 2026, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në sektorin e energjisë elektrike.

Informacioni mbi hapjen e konsultimit publik u shpërnda njëpërmjet publikimit të projektligjit dhe paketës shoqëruese në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në seksionin “Konsultimet Publike”.

Palët e interesuara u ftuan të kontribuojnë njëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit, përfshirë Regjistrin Elektronik, postën elektronike të koordinatorit për konsultimin publik, si dhe komunikimet me e-mail drejtuar grupeve të interesit. Gjithashtu, grupet e interesit u përfshinë edhe njëpërmjet tryezave të rumbullakëta të konsultimit, të zhvilluara më datë 19 mars 2026 dhe 8 prill 2026.

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.*

*Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.*

*Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.*

Palët e interesuara të përfshira në procesin e konsultimit përfshijnë publikun e gjerë, qytetarët dhe çdo përfaqësues tjetër të publikut të interesuar, si dhe grupet e interesit që ushtrojnë veprimtari në sektorin e energjisë elektrike.

Në kuadër të konsultimeve janë përfshirë këto grupe interesi: AI EnergyX, HEC Bishnica 1,2, SPV Blue, Euron Energy, Voltalia, Nova Solar System, Sunny Side

Energy, Seman Sunpower, Erseka Sol Park, 5GX Energy, HD Solar Park, Grennat SolPark Ballsh, Albpower, EZ-5 Energy, Ener Trade, Infotelecom-Albsolar4, Gjonaj Group Holdings, Devoll Hydropower, AREA dhe FIAA, etj.

Gjithashtu, në procesin ndërinstucional të hartimit dhe konsultimit të projektligjit janë përfshirë institucionet përgjegjëse dhe strukturat përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfshirë Drejtorinë e Programimit, Standardizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, si dhe koordinatori për konsultimin publik në ministri.

Palët e interesuara në kuadër ndërinstucional të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projekt akti, janë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Mjedisit.

#### 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën; Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”, ka pasur 416 lexime nga qytetarët, 375 lexime nga ekspertët dhe 43 komente nëpërmjet faqes së Regjistrimit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe website i MIE.

Nr	Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbullo ni dhe përmbledhn i komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
1	Riformulimi i nenit 3, pika 73 (“ndarja e energjisë		Anduel Cekrezi, AI Energy X	Refuzuar	Projektligji e trajton ndarjen e energjisë elektrike si një

	<p>elektrike”), me qëllim lejimin e ndarjes përmes rrjetit të transmetimit dhe/ose shpërndarjes, pa u kufizuar në të njëjtin vendndodhje fizike; është paraqitur propozim konkret formulimi.</p>				<p>veprimtari furnizimi që përjashtohet nga detyrimi për licencim të furnizimit. Paralelisht, neni 3, pika 28, i ligjit nr. 24/2023 “Për burimet e rinovueshme të energjisë” (në zbatim të Direktivës (BE) për energjinë e rinovueshme – RED) e përcakton “ndarjen e energjisë” si një koncept të veçantë. Duhet të sqarohet me OSSh dhe ERE nëse ky përjashtim nga licencimi zbatohet edhe për veprimtaritë e furnizimit të realizuara përtej një vendndodhjeje të vetme fizike.</p>
2	<p>Propozim për një nen të ri mbi sigurinë juridike dhe stabilitetin rregullator; është paraqitur</p>		Shoqata AREA	Refuzuar	<p>Lidhet me zbatimin e Direktivës (BE) për energjinë e rinovueshme (RED).</p>

	propozim konkret formulimi.				
3	Përfshirja e hidrocentraleve me pompim (pumped storage) nga përkufizimi i depozitimit të energjisë (neni 3, pika 14): kërkohet zëvendësimi i shprehjes “duke përfshirë hidrocentralet me pompim” me “duke përfshirë hidrocentralet me pompim”.		DEVOLL HYDROPOWER sh.a.	Pranuar, pjesërisht	Përkufizimi i depozitimit të energjisë, si dhe vendimi për të përfshirë hidrocentralet me pompim, është rezultat i raundeve të mëparshme të konsultimeve me palët e interesuara. Megjithatë, kjo qasje mund të rishqyrtohet, duke qenë se ekzistojnë argumente dhe precedentë evropianë për kualifikimin e hidrocentraleve me pompim si njëkohësisht veprimtari prodhimi dhe depozitim të energjisë. Për më tepër, terminologjia e Direktivës (BE) 2019/944 do të lejonte gjithashtu përfshirjen e hidrocentraleve me pompim brenda përkufizimit të

					depozitimit të energjisë. Për sa më sipër, rekomandohet zhvillimi i diskutimeve të mëtejshme mbi këtë çështje. Nëse Ministria do të mbështesë një qasje të tillë, përkufizimi i depozitimit të energjisë duhet të ndryshohet në mënyrë që të përfshijë edhe hidrocentralet me pompim tek projekt ligji.
4	Propozim për ndryshimin e nenit 52: klasifikimi i instalimeve të depozitimit të energjisë brenda impianteve ekzistuese të prodhimit në Kategorinë I (optimizim, pa nevojë për miratim të ri) dhe Kategorinë II (ritje kapaciteti, që kërkon miratim të plotë); është paraqitur propozim		Shoqata AREA dhe ERSEKA SOLAR PARK 1 sh.p.k.	Pranuar, pjesërisht	Sipas acquis të Bashkimit Evropian, prodhimi dhe ruajtja e energjisë mund të kryhen brenda të njëjtit subjekt juridik; megjithatë, ato duhet të ndahen në mënyrë të arsyeshme në aspektin operacional dhe kontabël, duke përfshirë, kur është e nevojshme, sisteme të veçanta matjeje dhe mekanizma

	konkret formulimi.			<p>të veçantë për shlyerjen/likuidi min e energjisë. Regjistrimi ose licencimi i veçantë i njësive të ruajtjes është zakonisht i nevojshëm për të mundësuar mbikëqyrjen e duhur teknike nga ERE/OST, si dhe pjesëmarrjen në treg, përfshirë kualifikimin për aFRR dhe shërbime të tjera ndihmëse.</p> <p>Nga ana tjetër, disa shtete anëtare zbatojnë regjime të thjeshtuara për instalimet që nuk eksportojnë energji elektrike në rrjetin publik (p.sh. skemat e vetë konsumit ose “zero-export”), duke u mbështetur shpesh në regjistrim ose në përjashtime të posaçme nga licencimi, në vend të një licence të plotë furnizimi. Një kategori e tillë mund të</p>
--	--------------------	--	--	--

					justifikohet për të lehtësuar trajtimin preferencial të synuar, aty ku lejohet, si p.sh. përjashtime të veçanta nga taksat ose tarifat.
5	Propozim për dispozita mbi bashkë investimin në infrastrukturën e rrjetit: bashkëpunimi ndërmjet OST/OSSh/TS O dhe investitorëve privatë për përmirësimin ose ndërtimin e infrastrukturës së re, investime në interes publik, si dhe mekanizma kompensimi/stimulimi; është paraqitur propozim konkret formulimi.		SPV BLUE sh.p.k. ALBPOWER sh.p.k	Pranuar	Një propozim i ngjashëm është paraqitur nga OST dhe do të merret në konsideratë gjatë finalizimit të propozimit për ndryshimin e projektligjit.
6	Propozim për ndryshime në nenet 29 dhe 32 mbi aksesin në rrjet: përcaktimi i kriterëve objektive për lidhjen,		Shoqata AREA	Refuzuar	Nenet 32–36 të projektligjit përcaktojnë rregullat dhe parimet e përgjithshme kryesore mbi aksesin në rrjet.

	procedura të standardizuara, afate të qarta, mekanizma ankimi, transparencë tarifore, si dhe detyrimi për të arsyetuar refuzimet; është paraqitur propozim konkret formulimi.				Më tej, rregullat e detajuara do të përcaktohen në aktet nënligjore përkatëse.
7	Propozim për shtesa në nenin 92 mbi matjen e energjisë: matje e saktë dhe e verifikueshme, detyrime për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave, si dhe akses transparent në të dhëna për qëllime faturimi, balancimi dhe kompensimi; është paraqitur propozim konkret formulimi.		Shoqata AREA	Pranuar, pjesërisht	Nenet 92–94 të projektligjit përcaktojnë rregullat dhe parimet bazë mbi matjen e energjisë. Kërkesat e detajuara do të përcaktohen në aktet nënligjore përkatëse. Gjithashtu, neni 28 i projektligjit, së bashku me aktet e tij zbatuese, do të rregullojë menaxhimin dhe shkëmbimin e të dhënave të klientëve fundorë nga palët e autorizuara.
8	Propozim për një nen të ri mbi kufizimin e prodhimit		Shoqata AREA	Pranuar, pjesërisht	Neni 68, pika 1, pika 7 i projektligjit, së bashku me

	(curtailment) dhe kompensimin: kufizimi i prodhimit të zbatohet vetëm për arsye të sigurisë së sistemit, në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, si dhe e drejta për kompensim të plotë dhe të drejtë për prodhuesit në rastet kur kufizimi nuk është pasojë e një shkeljeje; është paraqitur propozim konkret formulimi.				shënimet shpjeguese përkatëse, e trajton kompensimin për kufizimin e prodhimit (curtailment), në përputhje me Direktivën si dhe në nenin 69 pika 2 e trajton kompensimin.
9	Propozim për riformulimin e nenit 52, pikat 2 dhe 4: përcaktimi i kriterëve të vlerësimit për kapacitetet e reja të prodhimit/ruajtjes, si dhe parashikimi i një dispozite të re për ankim, që kërkon vendimmarrje të arsyetuara,		Shoqata AREA	Refuzuar	Rregullat e detajuara që rregullojnë procedurat e licencimit — përfshirë ato që lidhen me çështjet e theksuara — duhet të përcaktohen në aktet nënligjore përkatëse, dhe jo në projektligj.

	objektive dhe jo diskriminuese, të cilat i nënshtrohen shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor; është paraqitur propozim konkret formulimi.				
10	Propozim për ndryshimin e nenit 52: ndërtimi i kapaciteteve të reja të prodhimit/ruajtjes në kuadër të mekanizmave të kapacitetit të përdoret vetëm si masë e fundit (last resort), si dhe plotësimi i pikës 1 me kërkesën që rezultatet e konsultimeve të merren në konsideratë në procesin e vendimmarrjes; është paraqitur propozim konkret formulimi.		Shoqata AREA	Pranuar, pjesërisht	Këto propozime janë tashmë të nënkuptuara në tekstin e propozuar të nenit 52 të projektligjit dhe të nenit 53 të projekt ligjit pika 1, si dhe të pikës 3 të nenit 4 të ligjit.
11	Propozim për ndryshimin e nenit 55: drejta e prodhuesve nga burime të		Shoqata AREA	Pranuar, pjesërisht	Neni 55 i propozuar i projektligjit tashmë u njeh prodhuesve nga burime të

	<p>rinovueshme të energjisë (përfshirë hidrocentralet me derivacion) për të instaluar, zotëruar, zhvilluar dhe operuar sisteme të ruajtjes së energjisë (përfshirë bateritë dhe hidrocentralet me pompim), si pjesë përbërëse e veprimtarisë së prodhimit, pa u konsideruar si veprimtari e veçantë furnizimi apo tregtimi.</p>				<p>rinovueshme të energjisë të drejtën për të instaluar, operuar dhe mirëmbajtur njësi të ruajtjes së energjisë, dhe në këtë drejtim nuk ekziston asnjë kufizim që bie ndesh me këtë të drejtë.</p>
12	<p>Propozim për riformulimin e nenit 55, pika 1, shkronja “b”: përfshirja e së drejtës së operatorëve të ruajtjes së energjisë për të blerë energji elektrike (krahas së drejtës për ta shitur), duke mundësuar realizimin e plotë të ciklit teknologjik të ruajtjes së energjisë</p>		<p>Shoqata AREA dhe ERSEKA SOLAR PARK 1 sh.p.k.</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Nuk është e nevojshme të theksohet në mënyrë të shprehur e drejta për blerjen e energjisë elektrike, pasi ajo është tashmë e nënkuptuar. Kjo për shkak se blerja e energjisë elektrike, ndryshe nga shitja e saj, nuk përbën një veprimtari të rregulluar.</p>

	(ngarkim–shkarkim).				
13	<p>Propozim për nene të reja mbi organizimin dhe transparencën e tregut të balancimit: akses i hapur për prodhuesit, operatorët e ruajtjes së energjisë, agregatorët dhe pjesëmarrësit në përgjigjen e kërkesës (demand response); publikimi i çmimeve të balancimit, ofertave dhe të dhënave të aktivizimit; rregulla transparente për formimin e çmimeve; është paraqitur propozim konkret formulimi.</p>		Shoqata AREA	Refuzuar	<p>Teksti i propozuar i neneve 125–126 të projektligjit përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me përgjegjësinë për balancimin dhe tregun e balancimit. Në përputhje me këto dispozita dhe me shënimet shpjeguese përkatëse, aktet nënligjore përkatëse do të sigurojnë kuadrin e duhur rregullator për tregun e balancimit. Duke qenë se balancimi i energjisë elektrike është një fushë në zhvillim të shpejtë, rekomandohet që rregullat e detajuara t'i lihen rregulloreve të ERE-s dhe kodeve të rjetit, në mënyrë që të mundësohet</p>

					përshtatje e shpejtë sipas nevojës.
14	Propozim për përjashtimin nga përgjegjësia financiare për disbalancat për të gjithë prodhuesit me kapacitet të instaluar nën 2 MË.		Shoqata AREA	Pranuar, pjesërisht	Rregullorja (BE) 2019/943 parashikon një përjashtim të kufizuar nga përgjegjësia për balancimin. Përjashtimet e mundshme në këtë kuadër janë tashmë të pasqyruara në tekstin e propozuar të nenit 99 të projektligjit, përkatësisht për projektet demonstrative, prodhuesit nga burime të rinovueshme me kapacitet nën 400 kW (nën 200 kW nga viti 2026), si dhe prodhuesit që përfitojnë mbështetje financiare.
15	Propozim për nene të reja mbi pavarësinë e ERE-s, transparencën e vendimmarrjes, parandalimin e konflikteve të interesit dhe të		Shoqata AREA	Refuzuar	Nenet 18–25 të projektligjit synojnë të transpozojnë kërkesat përkatëse të acquis të Bashkimit Evropian në

	drejtën e ankimit; është paraqitur propozim konkret formulimi.				nivel rregullash dhe parimesh të përgjithshme. Dispozitat më të detajuara do të parashikohen në aktet nënligjore përkatëse. Dispozitat që garantojnë pavarësinë e ERE-s do t'i nënshtrohen një shqyrtimi të veçantë nga Komuniteti i Energjisë përpara miratimit të tekstit përfundimtar të projektligjit. Në rast se teksti i propozuar vlerësohet i pamjaftueshëm nga Komuniteti i Energjisë, detaje të mëtejshme do të përfshihen në vetë projektligjin.
16	Propozim për krijimin dhe funksionimin e një tregu të Garancive të Origjinës (GO), në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.		SPV BLUE sh.p.k.	Pranuar	Kuadri rregullator për Garancitë e Origjinës (GO) parashikohet në ligjin nr. 24/2023 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, i cili është tashmë i përafuar me

					acquis përkatës të Bashkimit Evropian. Eshtë prekur edhe pak tek neni 101 pika 8 që deklarimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme do të bëhet nga garancitë e origjinës.
17	Kompensimi për ri planifikimin e dispeçimit jo të bazuar në treg duhet të përcaktohet mbi bazën e humbjes neto faktike të rezultuar nga pjesëmarrja në tregjet Day-Ahead (DAM) dhe Intraday (IDM), duke marrë në konsideratë edhe të ardhurat nga Garancitë e Origjinës (GO), si dhe duhet të zbatohet në mënyrë të automatizuar; formulat e qarta dhe të detajuara të llogaritjes duhet të parashikohen		SPV BLUE sh.p.k.	Pranuar, pjeswrusht	Neni 68(1) i projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), së bashku me shënimet shpjeguese përkatëse, trajton tashmë në mënyrë të detajuar kompensimin për kufizimin e prodhimit (curtailment).

	shprehimisht në kuadrin rregullator përkatës.				
18	Shkëputja e tarifave të aksesit në rrjet nga kapaciteti i instaluar: metodologjia tarifore duhet të lidhë tarifat e përdorimit të rrjetit me sasinë reale të energjisë së injektuar në rrjet, dhe jo me kapacitetin e instaluar.		SPV BLUE sh.p.k	Pranuar, pjesërisht	Metodologjia për llogaritjen e tarifave të rrjetit rregullohet në nivelin e rregulloreve të ERE-s dhe kodeve të rrjetit, dhe jo në nivelin e projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL).
19	Parashikim për nxitjen e mbështetjes fiskale dhe teknike për prodhuesit që integrojnë sisteme magazinimi të energjisë, me qëllim pjesëmarrjen në tregjet e balancimit dhe fleksibilitetit.		SPV BLUE sh.p.k	Refuzuar	Kjo përbën një çështje të politikë bërjes dhe bie jashtë objektit të rishikimit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), i cili kryhet për qëllime të përafrimit me acquis të Bashkimit Europian.
20	Sigurimi i transparencës dhe aksesit në të dhëna në kohë reale: të gjithë pjesëmarrësit në		SPV BLUE sh.p.k	Pranuar, pjesërisht	Neni i propozuar 28 i projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), së bashku me

	<p>treg duhet të kenë akses të barabartë në të dhënat operacionale të OST/OSSh përmes platformave të hapura (API, panele monitorimi/dash boards).</p>				<p>aktet nënligjore zbatuese përkatëse, do të rregullojë administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave të konsumatorëve fundorë nga palët e autorizuara.</p>
21	<p>Ndryshimet e propozuara në nenin 51 lidhur me licencimin e magazinimit të energjisë: krijimi i një kuadri për rregullimin e veprimtarive të magazinimit të energjisë si një kategori e veçantë brenda sektorit të energjisë elektrike, së bashku me një propozim konkret formulimi.</p>		<p>EZ-5 ENERGY sh.p.k</p>	<p>Pranuar, pjesërisht</p>	<p>Neni i propozuar 51 i Projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) parashikon tashmë një kuadër rregullator për licencimin e depozitimit të energjisë, duke përfshirë edhe masa kalimtare për të garantuar vijimësinë e operimit të njërive ekzistuese të magazinimit (ju lutemi referojuni licencës së përkohshme për operimin e objekteve të magazinimit të energjisë, sipas nenit 51, paragrafët 4–6 të PSL-së).</p>

22	<p>Sqarim terminologjik në nenin 52: zëvendësimi i shprehjes ‘kapacitete prodhuese dhe magazinuese’ me ‘kapacitete prodhuese dhe/ose magazinuese’, me qëllim mundësimin e zhvillimit të pavarur të projekteve të magazinimit të pavarur, të prodhimit, ose projekteve hibride.</p>		EZ-5 ENERGY sh.p.k	Pranuar	<p>Versioni aktual i nenit të propozuar 52 të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) mundëson tashmë zhvillimin e pavarur të projekteve të magazinimit të pavarur, të prodhimit, si dhe të projekteve hibride — pra, nuk nënkupton asnjë kufizim implicit.</p> <p>Versioni përfundimtar në gjuhën shqipe i ndryshimeve në PSL do ta pasqyrojë në mënyrë të saktë këtë dhe do të eliminojë çdo paqartësi të mundshme që rrjedh nga përkthimi.</p>
23	<p>Shtesë e propozuar e pikës (l) në nenin 52, paragrafi 2: pajisjet dhe makineritë për kapacitetet</p>		EZ-5 ENERGY sh.p.k	Refuzuar	<p>Kjo përbën një çështje të politikë bërjes, e cila përfshin aspekte thelbësore të politikës fiskale, dhe bie jashtë</p>

	prodhuese/magazinuese të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për TVSH-në dhe doganat.				objektit të rishikimit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), i cili kryhet për qëllime të përfrimit me acquis të Bashkimit European.
24	Shtesë e propozuar e pikës (m) në nenin 52, paragrafi 2: përjashtimi nga renta për kapacitetet e zhvilluara mbi bazë tregu dhe të financuara plotësisht me kapital privat, pa përdorimin e fondeve publike apo skemave mbështetëse.		EZ-5 ENERGY sh.p.k	Refuzuar	Kjo përbën një çështje të politikë bërjes, e cila përfshin aspekte thelbësore të politikës fiskale, dhe bie jashtë objektit të rishikimit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), i cili kryhet për qëllime të përfrimit me acquis të Bashkimit European.
25	Dispozitë përfundimtare e propozuar: ndryshimet ligjore ose nënligjore të zbatohen vetëm për marrëdhëniet juridike të		SEMAN SUNPOWER sh.p.k	Refuzuar	Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë

	krijuara pas hyrjes në fuqi, në lidhje me skemat e çmimeve të garantuara, si p.sh. tarifa e garantuar (feed-in tariff – FiT)				objektit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe nga aktet nënligjore përkatëse.
26	Shtesë në nenin 3 (Përkufizime): përcaktimi i ‘devijimit (imbalance)’ si diferenca ndërmjet sasisë së planifikuar/të nominuar dhe sasisë faktike të energjisë elektrike.		SEMAN SUNPOWER sh.p.k.	Refuzuar	Teksti i propozuar i neneve 125–126 të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me përgjegjësinë për balancim dhe tregun e balancimit. Në përputhje me këto dispozita dhe shënimet shpjeguese përkatëse, legjislacioni dytësor do të sigurojë kuadrin e duhur rregullator për tregun e balancimit. Duke

					qenë se balancimi i energjisë elektrike është një nga rregullat e detajuara të lihen në nivelin e rregulloreve të ERE-s dhe kodeve të rrjetit, me qëllim mundësimin e përshtatjes së shpejtë sipas nevojës.
27	Shtesë e propozuar e paragrafit 3 në nenin 30 lidhur me procedurat e lidhjes: ERE të miratojë një rregullore për lidhjet e reja, duke përfshirë metodologjinë e llogaritjes së kostove dhe marrëveshjen jo standarde të lidhjes, të bazuar në menaxhimin aktiv të sistemit elektro energjetik; kjo mundëson lidhjen e kapaciteteve plotësuese të prodhimit (p.sh. energji nga era)		ALBPOWER sh.p.k	Refuzuar	Paragrafi shtesë i propozuar 3 në nenin 30 të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) do të ishte i panevojshëm. Neni ekzistues 30, paragrafi 3 i PSL-së parashikon tashmë një bazë të mjaftueshme ligjore për ERE-n për të miratuar dhe ndryshuar rregulloren mbi rregullat dhe procedurat e lidhjes, përfshirë edhe ‘marrëveshjet jo standarde të lidhjes’ të referuara.

	në linja që operojnë në kapacitet nominal.				Legjislacioni dytësor përkatës në veçanti rregulloret përkatëse të ERE-s do të përfshijë dispozitat përkatëse për të nxitur këto kuadro kontraktore novatore.
28	Sqarim i përkufizimit të 'rishitjes së energjisë elektrike': përcaktimi i kufizimit të saj në një mjedis të mbyllur/të kufizuar, sqarimi i statusit të licencimit të subjektit që kryen rishitjen, si dhe kërkesa për një metodologji transparente dhe të bazuar në kosto, të miratuar nga ERE, për përcaktimin e çmimit maksimal.		GJONAJ GROUP HOLDINGS sh.p.k.	Refuzuar	Drafti i projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) e trajton rishitjen e energjisë elektrike si një veprimtari furnizimi, e cila përjashtohet nga detyrimi për licencim si furnizues. Paralelisht, neni 3, pika 28 e ligjit për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023, në zbatim të Direktivës së BE-së për energjinë nga burimet e rinovueshme – RED) e përkufizon 'ndarjen e

					<p>energjisë' si një koncept të veçantë. Legjislacioni dytësor i miratuar nga ERE do të rregullojë në mënyrë të detajuar veprimtaritë përkatëse. Sipas nenit të propozuar 40, paragrafi 7 të PSL-së, subjektet që ushtrojnë rishitjen e energjisë elektrike do t'i nënshtrohen të njëjtit nivel mbikëqyrjeje rregullatore si subjektet e licencuara.</p>
29	<p>Sqarim i 'kushteve lehtësuese' për lidhjen në rrjet: përfshirja e thjeshtimit të procedurave, përcaktimi i afateve transparente, publikimi i kapaciteteve të disponueshme, aplikimi i tarifave të</p>		<p>GJONAJ GROUP HOLDINGS sh.p.k.</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Neni i referuar 18, paragrafi 1 i projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) rendit objektivat e përgjithshme të ERE-s dhe shërben si një kuadër që plotësohet dhe konkretizohet përmes veprimtarisë së</p>

	<p>bazuara në kosto, si dhe zbatimi në mënyrë jo diskriminuese; gjithashtu adresohen dispozitat kalimtare për objektet ekzistuese të magazinimit dhe qartësia në lidhje me regjimin e licencimit.</p>				<p>ERE-s dhe legjislacionit dytësor të miratuar prej saj. Për rrjedhojë, nuk është e nevojshme që ky koncept të shtjellohet më tej në nivelin e vetë PSL-së. Kjo siguron që ERE të ruajë fleksibilitetin për të përdorur instrumentet rregullatore të nevojshme për arritjen e objektivit përkatës.</p>
30	<p>Propozim për të garantuar akses në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, kundrejt pagesës së tarifave përkatëse, me përjashtim të subjekteve prodhuese që kanë investuar në sisteme magazinimi të energjisë dhe të subjekteve që mbajnë kontrata mbështetëse për shitjen e</p>		<p>GJONAJ GROUP HOLDINGS sh.p.k.</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe</p>

	energjisë elektrike me çmim të fiksuar, të dhëna nga institucionet shtetërore.				nga legjislacioni dytësor përkatës.
31	Tarifat e aksesit në rrjet për magazinimin e energjisë: rekomandohet një qasje e balancuar për të shmangur tarifimin e dyfishtë, dhe jo një përjashtim i përgjithshëm nga tarifat; përjashtimi të aplikohet vetëm për ato tarifa që e trajtojnë energjinë e magazinuar si energji të prodhuar në momentin e injektimit në rrjet.		GJONAJ GROUP HOLDINGS sh.p.k.	Pranuar, pjesërisht	Ky përbën një propozim të arsyeshëm për të shmangur, ose të paktën për të kufizuar, tarifimin e dyfishtë të tarifave të rrjetit për njësitë e magazinimit të energjisë. Megjithatë, kjo është një çështje që duhet të trajtohet në nivelin e legjislacionit dytësor, në veçanti në rregulloret përkatëse mbi tarifat e rrjetit. Përfshirja e rregullave të detajuara në nivelin e Projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) do t'i hiqte ERE-s një instrument për të reaguar me shpejtësi ndaj kushteve të

					tregut në ndryshim të shpejtë, të shkaktuara nga vendosja e pritshme në shkallë të gjerë e njësisive të reja të magazinimit.
32	Trajtimi për TVSH-në i kontratave dypalëshe: kërkohet një përjashtim i shprehur nga TVSH-ja ose sqarimi i trajtimit fiskal për transaksionet e energjisë elektrike të realizuara përmes kontratave dypalëshe për energjinë e prodhuar nga burime të rinovueshme.		SPV BLUE sh.p.k. dhe ERSEKA SOLAR PARK 1 sh.p.k.	Refuzuar	Kjo përbën një çështje të politikë bërjes, e cila përfshin aspekte thelbësore të politikës fiskale, dhe bie jashtë objektit të rishikimit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), i cili kryhet për qëllime të përafrimit me acquis të Bashkimit Europian.
33	Zhvillimi i modeleve standarde të kontratave PPA: krijimi i një kuadri të posaçëm tregu ose vendosja e detyrimit për ERE-n për të hartuar dhe		SPV BLUE sh.p.k.	Refuzuar	Kjo përbën një çështje të politikë bërjes dhe bie jashtë objektit të rishikimit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), i cili kryhet për

	<p>publikuar modele standarde të kontratave të blerjes së energjisë (PPA) për prodhuesit nga burime të rinovueshme, me fuqi detyruese juridike për operatorët publikë.</p>				<p>qëllime të përafrimit me acquis të Bashkimit European. Pavarësisht kësaj, çdo model kontrate që mund të zhvillohet nga ERE, qoftë në bazë detyruese apo vullnetare duhet të trajtohet si një rekomandim dhe jo si një instrument juridik detyrues. Kjo qasje do t'i shërbente më mirë zhvillimit të tregut dhe do të nxiste inovacionin, në krahasim me modelet detyruese të kontratave, të cilat në mënyrë të pashmangshme mbeten pas zhvillimeve të tregut.</p>
34	<p>Trajtimi fiskal i drejtë i kontratave PPA: propozohet një dispozitë e re që parandalon tatimin e dyfishtë, ndalon</p>		<p>DEVOLL HYDROPOWER sh.a.</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Kjo përbën një çështje të politikë bërjes, e cila përfshin aspekte thelbësore të politikës fiskale, dhe bie jashtë</p>

	<p>rivlerësimin tatimor mbi bazën e çmimit të dakordësuar në kontratën PPA, mbron shitjet me humbje që rrjedhin nga kushtet e tregut, si dhe kërkon nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Financave dhe Ministria e Energjisë.</p>				<p>objektit të rishikimit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL), i cili kryhet për qëllime të përafritit me acquis të Bashkimit European</p>
35	<p>Dispozitë kalimtare e propozuar pas nenit 135: të gjitha kontratat e tarifave të garantuara (FiT), marrëveshjet e lidhjes në rrjet, kushtet e licencimit dhe marrëveshjet përkatëse të lidhura përpara hyrjes në fuqi të mbeten të vlefshme dhe plotësisht të zbatueshme.</p>		<p>SEMAN SUNPOWER sh.p.k.</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe nga legjislacioni dytësor përkatës).</p>

36	<p>Ruajtja e regjimit ekonomik të tarifave të garantuara (FiT): çmimi i garantuar, metodologjia e pagesës, periudha e mbështetjes, si dhe rregullat e matjes dhe faturimit të mbeten të pandryshuara gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.</p>		SEMAN SUNPOWER sh.p.k	Refuzuar	<p>Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe nga legjislacioni dytësor përkatës.</p>
37	<p>Shtesa të propozuara në nenin 68: ruajtja e përparësisë në lidhje në rrjet, aksesit në rrjet dhe dispeçimit me përparësi për mbajtësit e kontratave të tarifave të garantuara (FiT); si dhe një përkufizim i ngushtë i ‘modifikimit të rëndësishëm’, duke përjashtuar</p>		SEMAN SUNPOWER sh.p.k	Refuzuar	<p>Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të Projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme</p>

	mirëmbajtjen rutinë dhe zëvendësimin e pajisjeve ekuivalente.				(Ligji nr. 24/2023), si dhe nga legjislacioni dytësor përkatës).
38	Ndalimi i cenimit të drejtave të mbajtësve të kontratave të tarifave të garantuara (FiT) nga legjislacioni dytësor, rregulloret, kodet e rrjetit apo vendimet administrative.		SEMAN SUNPOWER sh.p.k	Refuzuar	Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të Projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe nga legjislacioni dytësor përkatës).
39	Ndalimi i uljes indirekte të ardhurave për mbajtësit e kontratave të tarifave të garantuara (FiT): ndalimi i çdo tarife, ngarkese, penalteti apo mekanizmi financiar që		SEMAN SUNPOWER sh.p.k	Refuzuar	Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të Projektligjit për Sektorin e

	redukon të ardhurat neto të garantuara sipas kontratës FiT.				Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe nga legjislacioni dytësor përkatës).
40	Shtesë e propozuar e një dispozite kompensimi për mbajtësit e kontratave të tarifave të garantuara (FiT) të prekur nga zbatimi i ligjit të ri ose i akteve nënligjore.		SEMAN SUNPOWER sh.p.k.	Refuzuar	Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të Projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe nga legjislacioni dytësor përkatës).
41	Shtesë e propozuar e së drejtës për ankim me efekt pezullues për mbajtësit e kontratave të		SEMAN SUNPOWER sh.p.k.	Refuzuar	Rregullat e zbatueshme për marrëdhëniet kontraktore që bien në fushën e zbatimit të tarifave të

	tarifave të garantuara (FiT) të prekur nga zbatimi i ligjit të ri ose i akteve nënligjore përkatëse.				garantuara (feed-in tariff – FiT) dalin jashtë objektit të Projektligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike (PSL) dhe rregullohen nga ligji për burimet e rinovueshme (Ligji nr. 24/2023), si dhe nga legjislacioni dytësor përkatës).
42	Rekomandimi fokusohet kryesisht në nevojën për qartësi ligjore, stabilitet rregullator dhe fleksibilitet në zbatimin e dispozitave të projektligjit për sektorin e energjisë elektrike. Në veçanti, FIAA ngre shqetësime lidhur me parashikueshmërinë e çmimeve për industrinë, trajtimin e prodhimit për vetëkonsum, qartësimin e koncepteve të		FIAA	Refuzuar	Lidhur me gjithë sa më sipër propozuar nga FIAA, sqarojmë se projekt-ligji ka një përputhshmëri pothuajse të plotë me direktivën e BE dhe gjithë paketën rregullator e të integritit të energjisë elektrike të BE dhe të gjitha konceptet e parashikuara në ligj janë në përputhje me direktivën. Megjithatë, ky projektligj përbën vetëm

<p>reja si komunitetet e energjisë, karikimi i automjeteve elektrike dhe depozitimi i energjisë, si dhe nevojën për shmangien e barrierave administrative dhe interpretimeve të ndryshme juridike.</p> <p>Gjithashtu, rekomandohet një qasje më pragmatike për tranzicionin e konsumatorëve drejt tregut të liberalizuar.</p> <p>-</p> <p>Paqëndrueshmëria e çmimeve dhe nevoja për parashikueshmëri.</p> <p>Duke qenë se drafti parashikon një treg më dinamik me luhatje të shpeshta çmimesh, konsiderojmë të rëndësishme mundësimin e instrumenteve</p>			<p>arkitekturën e funksionimit të tregut të energjisë elektrike dhe do të plotësohet në vijim me të gjithë aktet nënligjore dhe rregullatore të nevojshme, të cilat do të specifikojnë në mënyrë të plotë të gjitha specifikimet e lartpërmendura në propozimin e paraqitu.</p> <p>Gjithashtu, sqarojmë se gjatë hartimit të akteve nënligjore dhe rregullatore, këto akte do të konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha palët e interesit. Për sa i përket transparencës mbi burimin e energjisë, theksojmë se ajo trajtohet nga ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.</p>
--	--	--	--

<p>që garantojnë një nivel të arsyeshëm parashikueshmërie për konsumatorët industrialë, si kontratat afatgjata apo mekanizma të tjerë mbrojtës ndaj volatilitetit të tregut.</p> <p>- Rreziku i balancimit dhe faza e zhvillimit të tregut</p> <p>Në kushtet e një tregu ende në zhvillim, vështirësitë në parashikimin e saktë të konsumit mund të ekspozojnë bizneset ndaj rreziqeve të konsiderueshme financiare. Për këtë arsye, sugjerojmë që të parashikohen mekanizma lehtësues, përfshirë mundësinë e delegimit të përgjegjësisë së balancimit tek furnizuesit apo agreguesit, si</p>				
---	--	--	--	--

<p>dhe masa tranzitore.</p> <p>- Qartësimi i konceptit të “klientit aktiv”</p> <p>Drafti prezanton konceptin e klientit aktiv, i cili potencialisht përfshin edhe kompani në industrinë ushqimore. Megjithatë, mbetet i paqartë përcaktimi i “kufijve të përcaktuar” të aktivitetit.</p> <p>Rekomandojmë një saktësim të këtij koncepti, për të shmangur interpretimet e ndryshme dhe për të garantuar siguri juridike.</p> <p>- Karikimi i automjeteve elektrike (EV)</p> <p>Duke qenë se industria ushqimore është e angazhuar në tranzicionin drejt flotave të gjelbra, konsiderojmë</p>				
---	--	--	--	--

<p>thelbësore që ligji të diferencojë qartë ndërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• pikave të karikimit për përdorim të brendshëm (jo komercial), dhe</li> <li>• pikave të aksesueshme publikisht.</li> </ul> <p>Sugjerojmë që karikimi për përdorim të brendshëm të mos konsiderohet aktivitet tregtar dhe të mos i nënshtrohet kërkesave për licencim apo detyrimeve të tjera administrative.</p> <p>- Trajtimi i auto prodhimit dhe përdorimit të brendshëm të energjisë</p> <p>Drafti përfshin konceptin e vetë-prodhimit, por pa një trajtim të qartë për rastet e auto prodhimit 100%</p>				
--	--	--	--	--

<p>për konsum të brendshëm. Rekomandojmë që këto raste të perkufizohen qartë dhe të përjashtohen nga kërkesat e panevojshme rregullatore.</p> <p>- Depozitimi i energjisë (energy storage)</p> <p>Vlerësojmë përfshirjen e konceptit të depozitimit të energjisë, megjithatë perkufizimi aktual mbetet i paqartë. Sugjerojmë qartësimin e rolit dhe përgjegjësi, duke specifikuar se përdorimi i sistemeve të depozitimit për nevoja të brendshme nuk duhet të konsiderohet aktivitet i rregulluar apo i licencuar.</p> <p>- Detyrimet për raportim dhe</p>				
---	--	--	--	--

<p>barrë administrative</p> <p>Disa dispozita lidhur me raportimin e të dhënave mund të krijojnë paqartësi për kompanitë që prodhojnë dhe konsumojnë energji për nevojat e tyre. Rekomandojmë një qasje proporcionale, që shmang mbingarkesën administrative dhe përjashton rastet e vetë-konsumit nga kërkesa të panevojshme raportimi.</p> <p>- Transparenca mbi burimin e energjisë (renewable vs. fossil)</p> <p>Në funksion të kërkesave në rritje për raportim të qëndrueshmërisë, do të ishte e dobishme që kuadri ligjor të inkurajojë ose të parashikojë</p>				
---	--	--	--	--

	<p>transparencë mbi përbërjen e energjisë së furnizuar (burime të rinovueshme kundrejt burimeve fosile), duke ndihmuar kompanitë në përmbushjen e detyrimeve të raportimit.</p> <p>- Përmirësime teknike dhe harmonizim me acquis të BE-së.</p> <p>Së fundi, sugjerojmë adresimin e disa paqartësive teknike dhe përkufizimeve të paplota, si dhe një harmonizim të mëtejshëm me legjislacionin e BE-së, për të siguruar një kuadër të qartë, të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm në praktikë.</p>				
43	Drafti i ligjit paraqitet i strukturuar mirë në disa		Dr. Andrian Vaso Ekspert i VSM & VNMS	Pranuar, pjesërisht	Mjedisi është prekur në disa nene të ligjit 45, 104, 101, 79, 67,

<p>dimensione kyçe të zhvillimit të sektorit energjetik, duke reflektuar parime të thelbësore të reformës së tregut në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian. Në radhë të parë, ai është i fortë në drejtim të liberalizimit të tregut, pasi parashikon krijimin dhe feksionimin e një tregu konkurrues, të hapur dhe jo diskriminues, ku aktorë të ndryshëm mund të marrin pjesë në kushte të barabarta. Një tjetër element pozitiv është trajtimi i avancuar i rolit të konsumatorit. Drafti e zhvendos konsumatorin nga një rol pasiv në një rol aktiv në treg, duke përfshirë</p>				<p>55, 52, 45 neni 6 do kalojë me akt nënligjor Neni 102 do kalojë me akt nënligjor komunitetet qytetare të energjisë Neni 32 Aksesi i palëve të treta me akt nënligjor Neni 108 klientët në nevojë do të kalojnë me akte nënligjore Neni 4 pika 12 rregulla duhet të transpozojnë dhe zbatojnë dispozitat e Rregullores së BE-së mbi udhëzimet për infrastrukturën trans-evropiane të energjisë (TEN-E) dhe në veçanti, të adresojnë identifikimin dhe lehtësimin e Projekteve me Interes të Përbashkët dhe të Ndërsjellë (PCI dhe PMI), do të bëhem me akte nënligjore.</p>
---	--	--	--	---

<p>koncepte moderne si klienti aktiv, agregimi dhe reagimi ndaj kërkesës. Këto mekanizma i japin konsumatorit mundësinë të ndikojë në mënyrë direkte në konsumin dhe madje në tregtimin e energjisë, duke rritur efikasitetin dhe fleksibilitetin e sistemit.</p> <p>Gjithashtu, drafti demonstroi një qasje të mirë në drejtim të integritetit rajonal dhe forcimit të sigurisë së furnizimit. Ai parashikon mekanizma bashkëpunimi ndërkufitar, koordinim me strukturat rajonale dhe evropiane, si dhe masa për menaxhimin e rreziqeve dhe krizave në sektorin e</p>				
--	--	--	--	--

<p>energjisë, duke kontribuar në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit energjetik.</p> <p>Në fund, përfshirja e Komuniteteve të Qytetarëve për Energjinë (CEC / KQE) përbën një zhvillim të rëndësishëm dhe në përputhje me trendet evropiane. Ky koncept promovon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, autoriteteve vendore dhe ndërmarrjeve të vogla në prodhimin, konsumimin dhe menaxhimin e energjisë, duke synuar përfitime jo vetëm ekonomike, por edhe sociale dhe mjedisore për komunitetet lokale.</p> <p>Nga ana tjetër, dimensioni mjedisor dhe</p>				
---	--	--	--	--

<p>social mbetet dukshëm më pak i zhvilluar. Dispozitat përkatëse janë përgjithësisht deklarative dhe nuk përkthehen në detyrime konkrete, mekanizma zbatimi apo instrumente monitorimi. Për rrjedhojë, drafti vlerësohet i dobët në adresimin e kërkesave mjedisore dhe sociale në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Drafti paraqitet i dobët dhe me mangësi në dimensionin mjedisor dhe social operacional, krahasuar me kërkesat nga: Direktiva (BE) 2019/944 (tregu i energjisë elektrike); Direktiva 2012/27/BE (eficienca energjetike);</p>				
---	--	--	--	--

<p>Direktiva 2018/2001/BE (RED II – energjitë e rinovueshme);  Direktiva 2011/92/BE (ESIA/VNMS);  Direktiva 2001/42/BE (SEA/VSM);  Konventa e Aarhus (pjesëmarrja publike).  Në përmbledhje, ndërhyrjet kryesore të nevojshme në draft duhet të orientohen drejt forcimit dhe plotësimit të disa neneve kyçe, në mënyrë që ligji të arrijë një balancë më të mirë midis funksionimit të tregut, kërkesave mjedisore dhe dimensionit social.  Në këtë kuadër, është e rëndësishme që të forcohen Nenet 1, 2 dhe 4, të cilat përbëjnë bazën e primeve dhe</p>				
---	--	--	--	--

<p>politikave të sektorit. Këto dispozita duhet të pasurohen me elementë më të qartë dhe detyrues në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, përfshirjen sociale dhe përputhshmërinë e me standardet e Bashkimit Evropian, duke kaluar nga formulime të përgjithshme në mekanizma konkretë zbatimi. Paralelisht, kërkohet zgjerimi i neneve 5 dhe 6, të cilat lidhen me të dhënat dhe menaxhimin e riskut. Këto nene duhet të përfshijnë jo vetëm aspektet teknike të sistemit energjetik, por edhe indikatorë mjedisorë dhe socialë, si dhe analiza më të plota të rreziqeve,</p>				
--	--	--	--	--

<p>përfshirë ato klimatike. Kjo do të mundësonte një qasje më të integruar dhe pro aktive ndaj sfidave të sektorit.</p> <p>Së fundi, është e nevojshme të përmirësohen Nenet 7 dhe 8, që rregullojnë operimin e sistemit dhe aksesin në treg. Këtu duhet të reflektohen më qartë parimet e aksesit të drejtë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë edhe aktorë të rinj si komunitetet e energjisë, si dhe të sigurohet që operimi i sistemit të jetë në përputhje jo vetëm me efikasitetin teknik, por edhe me kërkesat mjedisore dhe sociale.</p>				
<p>Në aspektin mjedisor, është e domosdoshme që ligji të</p>				

<p>parashikojë në mënyrë të qartë dhe detyruese integrimin e instrumenteve kryesore të vlerësimit të ndikimit, përfshirë Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (EIA) dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (SEA), në të gjitha fazat e planifikimit dhe zhvillimit të projekteve dhe politikave energjetike.</p> <p>Në të njëjtën kohë, duhet të përfshihet edhe parimi “Do No Significant Harm” (DNSH), duke garantuar që asnjë ndërhyrje në sektorin energjetik të mos shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis apo në komponentët kryesorë të tij.</p> <p>Gjithashtu, rekomandohet vendosja e indikatorëve të</p>				
---	--	--	--	--

<p>matshëm dhe të detyrueshëm për monitorimin e performancës mjedisore, veçanërisht në lidhje me emetimet e gazeve serrë (GHG) dhe nivelin e përdorimit të energjisë së pastër. Këta indikatorë duhet të shoqërohen me mekanizma raportimi dhe verifikimi.</p> <p>Një element tjetër thelbësor është përfshirja e masave konkrete për mbrojtjen e biodiversitetit, veçanërisht në zonat e ndjeshme mjedisore, duke siguruar që zhvillimet energjetike të shmangin, minimizojnë ose kompensojnë ndikimet negative.</p> <p>Paralelisht, ligji duhet të kërkojë kryerjen e vlerësimeve të</p>				
--	--	--	--	--

<p> reziqut klimatik (climate risk assessment), për të garantuar që infrastruktura energjetike të jetë e qëndrueshme dhe e përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike. Në dimensionin social, është e nevojshme të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe të detajuar grupet vulnerabël që kërkojnë mbrojtje të veçantë, duke përfshirë kategori të tilla si familjet me të ardhura të ulëta, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera në nevojë. Ligji duhet gjithashtu të parashikojë masa konkrete për adresimin e varfërisë energjetike (energy poverty), duke përfshirë </p>				
--	--	--	--	--

<p>mekanizma mbështetës si subvencionet, tarifat sociale apo instrumente të tjera që sigurojnë akses të përballeshëm në energji.</p> <p>Një element i rëndësishëm është ndalimi i ndërprerjes së furnizimit me energji për kategori të caktuara të mbrojtura, veçanërisht në periudha kritike apo në kushte të vështira sociale.</p> <p>Për më tepër, duhet të integrohet qasja e “Just Transition”, duke siguruar që tranzicioni drejt një sistemi energjetik të qëndrueshëm të jetë socialisht i drejtë dhe të mos krijojë pabarazi apo përjashtim social.</p> <p>Për sa i përket Komuniteteve të Qytetarëve për Energjinë,</p>					
---	--	--	--	--	--

<p>rekomandohet që ligji të krijojë kushte reale për funksionimin dhe zhvillimin e tyre.</p> <p>Kjo përfshin lehtësimin e procedurave të licencimit dhe reduktimin e barrierave administrative për krijimin dhe operimin e këtyre komuniteteve. Njëkohësisht, duhet të garantohet akses prioritar dhe i drejtë në rrjetet e energjisë, në mënyrë që këto komunitete të mund të prodhojnë, konsumojnë dhe tregtojnë energjinë në mënyrë efektive. Për të nxitur zhvillimin e tyre, është e rëndësishme të parashikohen edhe skema të posaçme financimi dhe subvencionesh,</p>				
--	--	--	--	--

<p>që mbështesin investimet dhe pjesëmarrjen e tyre në treg. Në lidhje me organizatat e shoqërisë civile (OJQ/OJF), është e nevojshme që ligji të institucionalizojë rolin e tyre në mënyrë të qartë dhe të detyrueshme. Kjo nënkupton përfshirjen e tyre formale në proceset e konsultimit publik, në mekanizmat e monitorimit të zbatimit të ligjit dhe në faza të caktuara të vendimmarrjes. Gjithashtu, duhet të krijohen mekanizma të fortë transparence dhe llogaridhënieje, të cilët garantojnë akses në informacion, pjesëmarrje efektive dhe mundësi për</p>				
---	--	--	--	--

<p>mbikëqyrje të pavarur nga shoqëria civile. Kjo është thelbësore për të siguruar një qeverisje të hapur dhe në përputhje me standardet evropiane.</p> <p>Integrimi i detyrueshëm i EIA / SEA dhe DNSH</p> <p>Dispozitat aktuale nuk e bëjnë të detyrueshëm integrimin e instrumenteve mjedisore. Për këtë arsye:</p> <p>Neni 4 (Politikat e sektorit të energjisë elektrike) duhet të plotësohet duke përfshirë detyrimin që Strategjia Kombëtare e Energjisë dhe programet sektoriale t'i nënshtrohen Vlerësimit Strategjik Mjedisor (SEA/VSM).</p>				
--	--	--	--	--

<p>Neni 2 (Objekti i ligjit) duhet të zgjerohet për të përfshirë detyrimin që të gjitha projektet energjetike t'i nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (ESIA/VNMS). Gjithashtu, në Nenin 1 (Qëllimi i ligjit) duhet të shtohet në mënyrë eksplicite parimi “Do No Significant Harm – Mos shkakto dëm të konsiderueshëm” (DNSH/MSHD K) si parim udhëheqës.</p> <p>A.2. Vendosja e indikatorëve mjedisorë (GHG dhe energji e pastër)</p> <p>Aktualisht mungojnë indikatorë të matshëm për performancën mjedisore.</p> <p>Neni 4 duhet të plotësohet me</p>				
---	--	--	--	--

<p>detyrimin për vendosjen e indikatorëve kombëtarë për: emetimet e gazeve serrë (GHG); përqindjen e energjisë së rinovueshme.</p> <p>Neni 5 (Të dhëna dhe informacione) duhet të zgjerohet për të përfshirë raportimin e detyrueshëm të këtyre indikatorëve nga operatorët e tregut.</p> <p>A.3. Mbrojtja e biodiversitetit</p> <p>Drafti nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë biodiversitetin.</p> <p>Neni 4/8 (rregullat për infrastrukturën TEN-E) duhet të plotësohet duke përfshirë kërkesa të qarta për: shmangien e ndikimeve në zona të mbrojtura;</p>				
--	--	--	--	--

<p>masa “avoid–mitigate–offset” (shmang – minimizo – kompenso). Neni 7 (Siguria e rrjetit dhe cilësia e furnizimit) mund të zgjerohet për të përfshirë kërkesa që zhvillimi i rrjetit të jetë në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.</p> <p>A.4. Vlerësimi i rrezikut klimatik (Climate Risk Assessment)</p> <p>Aktualisht trajtohet vetëm siguria e furnizimit, jo rreziku klimatik.</p> <p>Neni 6 (Gatishmëria ndaj riskut) duhet të zgjerohet për të përfshirë detyrimin për: analizë të rrezikut klimatik (p.sh.</p>				
---	--	--	--	--

<p>përmbytje, temperatura ekstreme); masa adaptimi për infrastrukturën energjetike.</p> <p>B. Dimensioni Social</p> <p>B.1. Definimi i grupeve vulnerabël</p> <p>Koncepti ekziston, por është i paqartë.</p> <p>Neni 3 (Përkufizime) – pika për “klient në nevojë” duhet të zgjerohet me kritere të qarta sociale dhe ekonomike.</p> <p>Neni 1 (Qëllimi i ligjit) duhet të përfshijë në mënyrë eksplicite mbrojtjen e grupeve vulnerabël si objektiv.</p> <p>B.2. Masa kundër varfërisë energjetike (Energy Poverty)</p> <p>Aktualisht mungojnë</p>				
---	--	--	--	--

<p>mekanizma konkretë.</p> <p>Neni 4 (Politikat) duhet të përfshijë detyrimin për politika kombëtare kundër varfërisë energjetike.</p> <p>Neni 8 (Balanca kërkesë–prodhim) mund të zgjerohet për të përfshirë masa që sigurojnë akses të përballeshëm në energji.</p> <p>B.3. Ndalimi i ndërprerjes për kategori të caktuara</p> <p>Ekziston vetëm në mënyrë indirekte në skenarët e krizës.</p> <p>Neni 6 (Gatishmëria ndaj riskut) duhet të forcohet duke: përcaktuar qartë kategoritë që nuk mund të shkëputen nga energjia;</p>				
---	--	--	--	--

<p>vendosur kushte dhe procedura të detyrueshme për mbrojtjen e tyre.</p> <p>B.4. Integrimi i konceptit “Just Transition” (Tranzicion i drejtë)</p> <p>Mungon plotësisht.</p> <p>Neni 1 (Qëllimi) duhet të përfshijë tranzicionin e drejtë si parim bazë.</p> <p>Neni 4 (Politikat) duhet të përfshijë masa për: mbështetjen e komuniteteve të prekura; adresimin e ndikimeve sociale të tranzicionit energjetik.</p> <p>C. Komunitetet e Qytetarëve për Energjinë</p> <p>C.1. Lehtësimi i licencimit</p> <p>Neni 2 dhe dispozitat mbi licencimin (më tej në ligj) duhet të përfshijnë:</p>				
---	--	--	--	--

<p>procedura të thjeshtuara për komunitetet energjetike.</p> <p>C.2. Akses prioritar në rrjet Neni 7 (Siguria e rrjetit) dhe dispozitat për operatorët e rrjetit duhet të përfshijnë: detyrimin për akses të drejtë dhe jo diskriminues për komunitetet; mundësisht prioritet për energjinë e prodhuar prej tyre.</p> <p>C.3. Skema financimi dhe subvencionesh Neni 4 (Politikat) duhet të zgjerohet për të përfshirë: mekanizma mbështetës financiarë për komunitetet e energjisë.</p> <p>D. Roli i OJQ/OJF-ve</p> <p>D.1. Roli formal në konsultime, monitorim dhe vendimmarrje Neni 6 (Gatishmëria ndaj riskut)</p>				
---	--	--	--	--

<p>duhet të zgjerohet për të përfshirë OJQ-të në proceset e konsultimit.</p> <p>Neni 4 (Politikat) duhet të përfshijë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e strategjive.</p> <p>Duhet të shtohen dispozita të reja për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e zbatimit të ligjit.</p> <p>D.2. Mekanizma transparence dhe llogaridhënieje</p> <p>Neni 5 (Të dhëna dhe informacione) duhet të zgjerohet për të garantuar: akses publik në informacion.</p> <p>Nenet 4 dhe 6 duhet të përfshijnë: detyrime për publikimin e informacionit; procedura konsultimi publik në</p>				
---	--	--	--	--

	përputhje me standardet e Bashkimit Europian dhe Konventën e Aarhus.				
--	---	--	--	--	--